Në bazë të të dhënave të monitorimit, si duket dhe nga grafi ku i mëposhtëm ajri urban në përgjithësi rezulton i pastër nga ndotësit e gaztë (SO2 dhe NO2), pasi në të gjithë stacionet e monitoruara vlerat mesatare vjetore janë brenda normave të lejuara të normës Shqiptare dhe standartit të BE përjashtim bën Tirana qendër ku kemi tejkalim të lehtë të standartit të BE. Kjo është e pritshme pasi burimi kryesor i ndotjes në zonën përreth stacionit është trafi ku i automjeteve që të shumta janë në orët e mëngjesit dhe të mbasdites.

**Ndotësit Fotokimik**

Në shumë mjedise urbane ndotësit fotokimike janë bërë burime kryesore të ndotjes së ajrit. Ata shkaktohen kryesisht nga përdorimi në rritje i automjeteve dhe shkarkimeve të tyre, si rezultat i reaksioneve kimike midis ndotësave primarë dhe përbërësve të tjerë të atmosferës. Zakonisht, për tu zhvilluar këto reaksione kanë të domosdoshme dritën e diellit, dhe si rezultat ato krijojnë smogun fotokimik, i cili është më i përhapur në zonat që kanë rrezatim diellor të konsideruëshëm. Hidrokarburet që vijnë nga shkarkimet e automjeteve dhe burime të tjera luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e ozonit në mjedisin urban. Jo i gjithë ozoni i shtresës së ulët të atmosferës vjen prej aktiviteteve njerëzore, por ai vjen dhe nga burime natyrore dhe nga difuzioni i një pjese të ozonit nga pjesa e sipërme e atmosferës. Kushtet e favorshme për krijimin e ozonit janë temperaturat e larta të ajrit mbi 32oC, rrezatim diellor intensiv dhe mungesa e reshjeve të shiut.

Në grafikët e mëposhtëm janë të dhënat vjetore në stacionin e Vlorës dhe Korcës krahasuar me normën vjetore Shqiptare ku shihet qartë se kemi një tejkalim të kësaj norme në të dy stacionet e monitoruara. Në stacionin e Vlorës kemi një tejkalim në masën 16 % ndërsa në stacionin e Korçës kemi një kapërcim të ulët të kësaj norme.
Në grafikun nr 5 kemi vlerat 8 orarëshe për periudhën në dy stacione të Poliklinikës qëndrore dhe ISHP-së për periudhën Janar-Dhjetor 2013. Nivelet e larta të ozonit hasen në muajt e verës për efekt të rrezatimit më të fortë diellor.

**Studimi i Gjëndjes së Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësore të Shqipërisë**

Vlerësimi i cilësisë së ujërave të lumenjve Drin, Buna, Mat, Erzen, Ishëm, Shkumbin, Seman dhe Vjose është kryer në bazë të rezultateve të parametrave fi ziko-kimike (temperatura, transparenca, pH, alkalinitet, percjellshmeria elektrike, Oksigjeni i tretur, NKO, NBO5, nitritet, nitratet, amoniaku, Ptotal) bërë në 18 stacione. Vlerësimi i cilësisë së ujërave të liqenit të Ohrit, Prespës dhe Shkodrës realizohet për treguesit fi ziko-kimike në 5 stacione. Monitorimi është kryer nga IEUM. Kohzgjatja e studimit Qershor-Dhjetor 2012. Analiza e rezultateve të monitorimit dhe vlerësimi i cilësisë së ujërave të lumenjve bëhet sipas pellgjeve lumore. Në aneks do të gjeni stacionet lumore dhe liqenore, të dhënat gjeografi ke të tyre dhe kodin në rrjetin e monitorimit si dhe rezultatet mesatare të monitorimit për 2012 Vlerësimi i cilësise së ujrave të lumenjve dhe liqeneve dhe krahasimi i vlerave të
parametrave kimike me normat përbën një nga kërkesat e në Direktivat e Bashkimit Evropian për monitorimin e gjëndjes së ujrave sipërfaqësore Për vlerësimin e cilësisë së ujërave të lumenjve dhe liqeneve janë përdorur vlerat limite të përcaktuara në Direktivën e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659, për cilësinë e ujërave të ëmbla për rritjen e peshqve dhe klasifi kimi i cilësisë së ujërave të ëmbla natyrore sipas Institutit për Studimet e Ujërave të Norvegjisë – NIVA.

Sipas këtij klasifi kimi, parametrat e cilësisë së ujërave të ëmbla mund të ndahen në dy grupe:

1- në grupin e parë bëjnë pjesë ushqyesit, lëndët organike, përbërësit acide, grimcat e ngurta dhe bakteriet e fekaleve në ujëra.

2- në grupin e dytë metalet e rënda në nivelet mikro në ujë, sedimente dhe peshq.
Analiza e rezultateve të monitorimit dhe vlerësimi i cilësisë së ujërave të lumenjve bëhet sipas pellgjeve lumore. Për vendmatjet lumore: temperatura, pH, alkalinitet, përcjellshmeria elektrike, Oksigjeni i tretur, NKO, NBO5, nitritet, nitratet, amoniaku, Ptotal.

Temperatura e ujit ka një shpërndarje të vlerave të tyre sipas stines dhe në përgjithësi me të njëjtën ecuri si edhe temperatura e ajrit. Prania e gazit karbonik në ujëra me alkalinitet të ulët i bën ato lehtësisht agresive. Ujrat me alkalinitet të lartë mbi 5 mg.ekuiv./L turbullohen shpejt gjatë qëndrimit të tyre në mjedis.

**Baseni i Vjosës**

Akuiferi kuaternar ujëmbajtës Vjosës

Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytëzohet aktualisht është rreth 90-110 L/sek në zonën Buduk Gjirokastër. Në Kafaraj shfrytëzohet sasia 700 l/sek. Në Novoselë shfrytëzohet Q=720 l/sek. Koefi centi i shfrytëzimit është K = 0.5- 0.7.

**T** - Temperatura e ujit në dy fazat e monitorimit varion T= 15-18 gradë Celsius, në vitin 2012 varion T= 15.7-16.6 gradë Celsius (norma 8-15, deri 20).

**pH** - në dy fazat e monitorimit varion 7.55-8.29. Sipas normës së lejuar për ujë të pijshëm ky tregues është brenda normës së lejuar (Ph = 6,5-8,5). Sipas vlerës së pH (përqëndrimi i jonit të hidrogjenit) janë ujëra të tipit alkalin të dobët me Ph =7-9.

Përmbajtja mesatare 5-vjecare 7.62-8.18. Fp- Fortësia e përgjithshme në zonën Buduk-Budishte në dy fazat e monitorimit varion Fp=8.4- 13.860 gjermane , tregues brenda normës se lejuar janë me fortësi mesatare.

**Mp**- Mineralizimi i përgjithshëm në dy fazat e monitorimit varion Mp=301.35-109o.56 mg/l, janë brenda normës së lejuar. Në shpimin Pish-Poro mineralizimi i përgjithshëm varion Mp=1239.01- 1344.46 mg/l, ky tregues është mbi normën e lejuar për ujë të pijshëm. Uji është i tipit hidrokarbonat-kalcium-magnezi. Përmbajtja mesatare 5 vjecare variojne Mpmes=380.29-945.12 mg/l dhe Mpmes=1291.73 mg/l ne Pish-Poro.

**Na** -Përmbajtja e Natriumit Na në Buduk e Budishte në dy fazat e monitorimit varion 5.52-102.81 mg/l, përmbajtje brenda STASH R dhe PML. Përmbajtja mesatare 5 vjecare varion 9.48-24.5541 mg/l në Buduk-Budishte, në Novosele-Kafaraj përmbajtja mesatare varion 61.18-89.95mg/l. Në Pish-Poro përmbajtja mesatare Na është 284.51 mg/l, mbi përmbajtjen maksimale të lejuar.

**Ca** -Përmbajtja e Kalciumit Ca në dy fazat e monitorimit varion 48.1-93.19 mg/l. Përmbajtja mesatare është 16.53 mg/l, është përmbajtje e ulët. Përmbajtja është brenda asaj të rekomanduar dhe nën PML. Ndryshimet e Ca në dy fazat e monitorimit janë të vogla, ato variojnë 1-3.01-6.01-21.04 mg/l. Përmbajtja mesatare 5 vjecare varion 41.45-65.75 mg/l.

**Mg** -Përmbajtja e Magnezit Mg në dy fazat e monitorimit varion 3.65-31.01 mg/l në zonën Buduk, 3.04-6.68mg/l në Budrishtë, 31.62-35.87mg/l në Novoselë. Në zonën Kafaraj-Pish-Poro përmbajtja e Mg varion 75.34-97.28mg/l, përmbajtja kjo mbi PML. Përmbajtja mesatare zonën Buduk-Budrishte, Novoselë varion 13.22-46.13mg/ll, ndërsa në Kafaraj- Pish-Poro përmbajtja mesatare varion 70.21-93.05 mg/l. Ndryshimet e Mg në dy fazat e monitorimit variojnë 3.84-4.25-4.31-10.57 mg/l deri27.36 mg/l në Buduk.

**Fe** -Pëmbajtja e Hekurit Fe në dy fazat e monitorimit varion 0.01-0.1 mg/l, takohet përmbajtje në normën e rekomanduar deri mbi PML në shpimin Kafaraj, Budrishte, Buduk, Pish-Poro. Përmbajtja mesatare 5 vjecare varion 0.041-0.0.97 mg/l. Ndryshimet e Fe në dy fazat e monitorimit variojnë 0.01-0.03-0.05-0.06 mg/l

**NH4** - Në fazën e parë të monitorimit nuk takohet përmbajtje e Amonjakut NH4 në shpimet e monitoruara në Buduk, Budrishte, Novoselë e Kafaraj. Në fazën e dytë takohet përmbajtje në sasinë 0.01 mg/l në shpimin Buduk, Budrishte, Novoselë, Kafaraj në sasinë 0.01 mg/l, përmbajtje kjo nën PML, përmbajtja maksimale e lejuar 0.1mg/l).

**Cl** -Përmbajtja e Klorit Cl në dy fazat e monitorimit varion në zonën Buduk-Bidrishtë varion 7.1-115.38 mg/l. Në Novoselë përmbajtja e Cl varion 39.05-58.58 mg/l vërehet ulje e saj krahasuar me vitin e kaluar. Përmbajtja e Cl në zonën Kafaraj – Pish-Poro varion 280.28-598.18 mg/l, përmbajtja e klorit Cl është e lartë, mbi përmbajtjen maksimale të lejuar.

**SO4** -Përmbajtja e Sulfateve SO4 në dy fazat e monitorimit në shpimet Buduk e Budrishtë varion 2.9-8.23 mg/l. Përmbajtja e Sulfateve SO4 është brenda asaj të rekomanduar. Në shpimet Novoselë, Kafaraj, Pish-Poro përmbajtja e Sulfateve SO4 varion 42.38-71.19mg/l, sasi kjo mbi rekomandimin por nën PML. Ndryshimet e SO4 në dy fazat e monitorimit variojnë 1.28-2.88-5.32-12.88-13.17 mg/l.

**NO3** - Përmbajtja e Nitrateve NO3 në dy fazat e monitorimit është e vogël. Ajo varion nga 0.2-4.65 mg/l, në vitin 2012 përmbajta e nitrateve varion nga 0.02-5.58 mg/l, sasi kjo brenda normës së lejuar (norma STASH 25-50 mg/l, BE 25-50mg/l). Ndryshimet në dy fazat e monitorimit janë të vogla, ato variojnë 0.07-0.09-0.25-1.55-3.74 mg/l.

**NO2** -Takohet përmbajtje e nitriteve në dy fazat e monitorimit. Në fazën e parë takohet përmbajtje në sasinë 0.03 mg/l në shpimin Kafaraj, në shpimet e tjerë nuk takohen Nitrite. Në fazën e dytë takohet përmbajte e nitriteve në sasine 0.02 mg/l në Novoselë dhe Pish-Poro. Në Buduk, Budrishte dhe Kafaraj takohet përmbajtje 0.01 mg/l.

**O2** - Përmbajtja e O2 në dy fazat e monitorimit varion 1.7-11.68mg/l, ne vitin 2012 varion 3.4-7.97 mg/l. Në dy analiza të fazës së dytë të monitorimit në Budrishtë përmbajtja e O2 është 10.65mg/l dhe Kafaraj është 11.68 mg/l, pra është mbi 8mg/l. Përmbajtja në analizat e tjera është më e vogël se norma STASH (norma:- jo më pak se 8).
Analiza për mikroelemente - janë kryer në shpimin Novoselë për Ni, Mn, Zn, Pb, Cu, Co, Cr. Në këto analiza ka përmbajtje të mikroelementeve: Ni=0.008-0.005 mg/l, Mn=0-0.004 mg/l, Zn=0.009-0.007 mg/l, Pb=0.008-0.04 mg/l, Cu=0.008-0.002mg/l, Co=0.042-0.004 mg/l, Cr=0.024-0.004 mg/l, Cd=0-0.002mg/l. Përmbajtja e mikroelementeve është në përmbajtjen e rekomanduar deri në PML

**Lumi Vjosa**
Në lumin Vjosë monitorimi realizohet në 2 stacione: Tri Urat - Çarshovë, Ura Vjetër Mifol që përfaqësojnë lumin në pikën e hyrjes në Shqipëri mund të themi rrjedha e sipërme dhe dhe pikën para derdhjes – rrjedha e poshtme

**- Temperatura** e ujit varion 24 – 25.30C per stacionet 3 Urat
Carshovë dhe Mifol në fazën e parë të monitorimit dhe 15.8 – 17.6 në muajin Tetor. - pH i UN varion nga 7.82 – 8.22 8.35 respektivisht për stacionet ura e Mifolit dhe 3 Urat Carshovë. Ndryshimet stinore luhaten në vlerat 0.53 – 0.67. Sipas vlerave limite të Direktivës Kuadër të Ujit, normës për mjedis ujor acid dhe alkalin ujrat e lumit Vjosa kanë gjendje të mirë. Ata janë neutralë (Ph = 6.5 - 9).

**- Alkaliniteti**– Nga matjet e kryera në laborator shohim se vlerat luhaten nga 145 – 168 mol/l sipas stacioneve respektivisht 3 Urat Carshovë dhe Mifol. Luhatjet stinore janë gati të pandjeshme 15 – 23 mol/l.

**- Përcjellshmëria elektrike**– Luhatet në vlerat 397 – 568 µS/cm respektivisht 3 Urat Carshovë dhe Mifol. Luhatjet më të mëdha nga stina në stinë janë në stacionin Çarshovë në vlerë 171 µS/cm.

- **Përmbajtja e oksigjenit të tretur** në lumin Vjosë luhatet në vlerat 6.09 – 9.2 mg/l ndërsa vlerat mesatare 8.27 dhe 7.65 mg/l. Përmbajtja e oksigjenit ulet ndjeshëm në fazën e dytë si rezultat i pikës ekstremale të periudhës ujëpaktë. Nivelet e oksigjenit në lumin Vjosa i klasifikojnë ujrat e këtij lumi si me cilësi të mirë.

## 4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.

### Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jo direkte)

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
Parimi i qasjes së integruar
Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
Parimi "Ndotësi paguan"
Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 "Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" dhe ne perputhje me kerkesat e VKM Nr. 686, date 29.07.2015 "Per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis" dhe ka si synim idnetifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera
b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
e) Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
f) Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
g) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.

**Ndikime te rendesishme gjate punimeve te shfrytezimit dhe impaktet gjate funksionimit te tij. (Per fazen e funksionimit, do te kryhet vleresim i detajuar i ndikimeve ne mjedis dhe do te pajiset me leje mjedisore te tipit B.)**

## Shkarkime ne uje

Ndertimi i kesaj karriere, gjate punimeve per ndertimin e tij nuk do te kete ndikime te rendesishme ne mjedis, pasi kjo zone ka rruge automobilistike deri ne afersi te zones. Rrjeti elektrik i zones eshte ekzistues, edhe per kete nuk do te ndertohet linje. Persa i perkete burimeve ujore per lagien e kantierit, nese nuk sigurohet nga burimet e zones, ekzistojne mundesite per hapjen e nje pusi. Per hapjen e pusit, subjekti duhet te marre miratimet perkatese me pare, duke perfshire edhe vleresimin e ndikimit ne mjedis nga cpimi dhe shfryteimi i pusit.
Persa i perkete ujerave qe mund te dalin nga aktiviteti i impiantit, ato duhet te shkarkohen detyrimisht ne nje vaske dekantuese dhe te ndertohet sistem me cikel te mbyllur me riqarkullim, ne menyre qe shkarkimet ne mjedis te ujerave industriale te jene zero. Nuk do te prodhohen ujera me perbreje kimikatesh apo te lende te rrezikshme.

## Emetimet ne ajer

Emetimet ne ajer lindin si rrjedhoje e punimeve te hapjes se sheshit dhe punimeve sistemuese, por edhe efekti i mjeteve te renda te transportit, keto punime shoqerohen me pluhura dhe me zhurma gjate procesit te punes, por per nje kohe relativisht te shkurter. Ndersa persa i perkete ndikimeve gjate funksionimit, do te jene serisht te njejtet elemente(pluhurat dhe zhurmat) por kete here te shkaktuara nga mulliri dhe motorret e transportiereve te gureve.
Emetimet ne ajer nga ky instalim vijne kryesisht nga pluhuri i cili mund te ngrihet nga faktoret klimatike nga lenda e pare e magazinuar ose nga llumi i vaskave nese do te depozitohet aty pa plan menaxhimi. Procesi i larjes dhe bluarjes se materialeve inerte i cili mund te shoqerohet me pluhur, megjithese eshte nje proces qe ndodh “ne te njome” dhe me pranine e ujit gjate gjithe kohes se funksionimit te mullirit, pavaresisht sezonit. Pra pluhurat nga perpunimi, vleresohen ne nivele problematike. Zhurmat mund te jene nje burim tjeter shqetesimi, ato pershkruhen ne paragrafin e meposhtem.

## Zhurmat dhe vibrimet

Zhurmat qe do te prodhohen gjate fazes ndertimore do te vijne kryesisht nga mjetet e transportit rrugor si dhe nga perdorimi i mjeteve te ngarkim-shkarkimit te materialeve. Nje aspekt tjeter i prodhimit te zhurmave eshte edhe procesi i hapjes se rrugeve dhe i montimit.
Zhurmat qe do te prodhohen gjate fazes se funksionimit. Gjithashtu nje faktor tjeter te prodhimit te zhurmes jane elektromotorret e transportiereve dhe hedhja e kalimi i materialit nga nje pozicion e nje faze ne tjetren. Nderkohe mjetet rrugore dhe zhurma e prodhuar nga vete personat qe do te punojne per kete aktivitet, nuk vleresohen me potencial ndikues.

Punëtorët që ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund dhe duhet të perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit(Kufje ose tapa per veshet). Ne kete ambjent nuk vleresohen nivele te tilla zhurme qe mund te shkaktojne deri ne shurdhimin e degjimit, por gjithesesi, masat mbrojtese jane rekomanduar te perdoren rregullisht. Aktiviteti ndodhet ne distance nga qendrat e banuara dhe si rrjedhoje ne rast se zbatohen kushtet teknike te mirefunksionimit, nuk sjell shqetesim per banoret persa i perkete pluhurave apo zhurmave.

**Ndikimi ne toke**

Keto procese do te ndikojne negativisht ne toke, kjo vjen si rezultat se do te zihet perfundimisht nje siperfaqe toke pavaresisht shtreses biologjike te saj, pavaresisht llojit dhe sasise se demit qe mund ti shkaktohet. Ndikimi ne toke konsiston ne ndryshimin e perberjes se shtreses siperfaqesore te tokes, si dhe humbje te tokes ne kete rast, siperfaqja ndodhet ne zone toke te pa fryteshme dhe me gjendje te demtuar nga hedhja e mbeturinave te ndryshme.

**Ndikimi ne Biodiversitet**

Kjo zonë nuk bënë pjesë në zonat e ndjeshme te zonave te mbrojtura me ligj, ky ndertim, nuk do te preke zona pyjore apo prerje pemesh, apo siperfaqe toke kullote. Kjo siperfaqe nuk ben pjese ne zona te mbrojtura, nuk paraqet interes per speciet e rrezikuara, ndertimi nuk do te prek tokat bujqesore dhe token aktive, me veti prodhuese te kulturave bujqesore. Gjithashtu, rekomandojme ruajtjen e distancave te nevojshme nga monumentet natyrore te mbrojtura me ligj.

**Ndikimi ne Mjedisin Social**

Ndikimi i ketij projekti ne mjedisin social, pritet te jete me efekte negative dhe pozitive. Gjate kryerjes se ketyre punimeve duhet te punesohen edhe disa punetore te zones e te qendrave te banuara me te aferta ne menyre qe te zbutet efekti ekonomik e social i banoreve te zones. Ceshtja e pronesise dhe shpronesimit duhet te zgjidhen nga vete investitori, duke i kompesuar pronaret me vleren e tregut dhe duke iu ofruar atyre mundesi punesimi apo te blerjes se tokave te tjera.

**Ndikimi ne peizazh**

Ndikimi ne peizazh do te jete i perkohshem per fazen e punimeve ndertimore, dhe i perhershem gjate funksionimit. Nese nuk kryhet rehabilitim, dhe nese nuk kryhet larja e materialit si lende e pare apo lagia e kantierit dhe e rrugeve te pa shtruara, gjate funksionimit do te jete nje peizazh i pa kendshem dhe problematik per zonen. Duhet te mbillen peme te larta ne perimetrin e impiantit, me qellim reduktimin e impaktit vizual nga rruga automobilistike dhe nga qendrat e banuara.

**Mbetjet e prodhuara**

Mbetje te ngurta qe prodhohen kryesisht jane ato urbane nga aktiviteti human, por edhe llumi i argjiles se vaskave dekantuese dhe te shesheve te depozitimit gjate funksionimit te aktivitetit. Nuk vleresohet aktivitet me prodhim te mbetjeve te ngurta te rrezikshme, pasi materiali eshte 100% i perdorshem per qellime te tjera. Llumi i vaskave dekantuese, kerkon trajtim te integruar dhe perdorim te tij ne zona ku nuk demtohet mjedisi biologjik, ujor dhe ai i tokave bujqesore, ai nuk mund te hidhet ne mjedise cfaredo lloji dhe pa nje miratim te autoriteteve pergjegjese per mbrojtjen e mjedisit dhe te tokes bujqesore.

## 5. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.

Informacion për shkarkimet në mjedis.

Ndertimi i karrieres, gjate punimeve per ndertimin e tij nuk do te kete ndikime te rendesishme ne mjedis, pasi kjo zone ka rruge automobilistike deri ne afersi te zones. Rrjeti elektrik i zones eshte ekzistues, edhe per kete nuk do te ndertohet linje. Persa i perkete burimeve ujore per lagien e kantierit, nese nuk sigurohet nga burimet e zones, ekzistojne mundesite per hapjen e nje pusi. Per hapjen e pusit, subjekti duhet te marre miratimet perkatese me pare, duke perfshire edhe vleresimin e ndikimit ne mjedis nga cpimi dhe shfryteimi i pusit.
Persa i perkete ujerave qe mund te dalin nga aktiviteti, ato duhet te shkarkohen detyrimisht ne nje vaske dekantuese dhe te ndertohet sistem me cikel te mbyllur me riqarkullim, ne menyre qe shkarkimet ne mjedis te ujerave industriale te jene zero. Nuk do te prodhohen ujera me perbreje kimikatesh apo te lende te rrezikshme.
Emetimet ne ajer lindin si rrjedhoje e punimeve te hapjes se sheshit dhe punimeve sistemuese, por edhe efekti i mjeteve te renda te transportit, keto punime shoqerohen me pluhura dhe me zhurma gjate procesit te punes, por per nje kohe relativisht te shkurter. Ndersa persa i perkete ndikimeve gjate funksionimit, do te jene serisht te njejtet elemente(pluhurat dhe zhurmat) por kete here te shkaktuara nga mulliri dhe motorret e transportiereve te gureve.
Emetimet ne ajer nga ky instalim vijne kryesisht nga pluhuri i cili mund te ngrihet nga faktoret klimatike nga lenda e pare e magazinuar ose nga llumi i vaskave nese do te depozitohet aty pa plan menaxhimi. Procesi i larjes dhe bluarjes se materialeve inerte i cili mund te shoqerohet me pluhur, megjithese eshte nje proces qe ndodh “ne te njome” dhe me pranine e ujit gjate gjithe kohes se funksionimit te mullirit, pavaresisht sezonit. Pra pluhurat nga perpunimi, vleresohen ne nivele problematike. Zhurmat mund te jene nje burim tjeter shqetesimi, ato pershkruhen ne paragrafin e meposhtem. Zhurmat qe do te prodhohen gjate fazes ndertimore do te vijne kryesisht nga mjetet e transportit rrugor si dhe nga perdorimi i mjeteve te ngarkim-shkarkimit te materialeve. Nje aspekt tjeter i prodhimit te zhurmave eshte edhe procesi i hapjes se rrugeve dhe i montimit te impaintit.
Zhurmat qe do te prodhohen gjate fazes se funksionimit. Gjithashtu nje faktor tjeter te prodhimit te zhurmes jane elektromotorret e transportiereve dhe hedhja e kalimi i materialit nga nje pozicion e nje faze ne tjeteren. Nderkohe mjetet rrugore dhe zhurma e prodhuar nga vete personat qe do te punojne per kete aktivitet, nuk vleresohen me potencial ndikues.
Punëtorët që ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund dhe duhet të perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit(Kufje ose tapa per veshet). Ne kete ambjent nuk vleresohen nivele te tilla zhurme qe mund te shkaktojne deri ne shurdhimin e degjimit, por gjithesesi, masat mbrojtese jane rekomanduar te perdoren rregullisht. Aktiviteti ndodhet ne distance nga qendrat e banuara dhe si rrjedhoje ne rast se zbatohen kushtet teknike te mirefunksionimit, nuk sjell shqetesim per banoret persa i perkete pluhurave apo zhurmave.
Mbetje te ngurta qe prodhohen kryesisht jane ato urbane nga aktiviteti human, por edhe llumi i argjiles se vaskave dekantuese dhe te shesheve te depozitimit gjate funksionimit te aktivitetit. Nuk vleresohet aktivitet me prodhim te mbetjeve te ngurta te rrezikshme, pasi materiali eshte 100% i perdorshem per qellime te tjera. Llumi i vaskave dekantuese, kerkon trajtim te integruar dhe perdorim te tij ne zona ku nuk demtohet mjedisi biologjik, ujor dhe ai i tokave bujqesore, ai nuk mund te hidhet ne mjedise cfaredo lloji dhe pa nje miratim te autoriteteve pergjegjese per mbrojtjen e mjedisit dhe te tokes bujqesore.

## 6. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.

Ndikimet e fazes ndertimore do te zgjasin 3-6 muaj, ndersa funksionimi pa afat, ne varesi te nevojave te zones per kete lloj aktiviteti.

## 7. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS

Nga punimet ndertimore, ndikimi ne mjedisin e zones do te kete efektet e tij ne nje distance te ngushte, me qindra metra, pra ne nje distance jo me te larget se 300-500m. Ky ndikim do te jete i perkohshem dhe nuk eshte me veti akumuluese ne mjedis. Nuk shkarkohen elemente te demshem per mjedisin, si ne ate ujor, per ajrin, token dhe per biodiversitetin, kjo eshte e vlefshme vetem nese kryhen me sukses dhe ne masen 100% masat e punimeve rehebilituese dhe te mbrojtjes nga erozioni. Ne te kundert, ndikimi ne mjedisin ujor mund te shtrihet me gjere. Ndikimi ne peizazh do te jete i perkohshem per fazen e punimeve, ndersa nese nuk kryhet rehabilitimi dhe te merren masa per reduktimin e impaktit ne peizazh, gjate funksionimit do te jete nje peizazh i pa kendshem dhe problematik per zonen.

## 8. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.

Mundesia e rehabilitimit te plote ekziston. Kjo strukture qe do te ndertohet do te jete metalike dhe e cmontueshme. Ne perfundim te aktivitetit, investitori, mund dhe duhet te kryeje rehabilitimin e plote te siperfaqeve te demtuara te zena nga impianti i fraksionimit dhe nga sheshet e depozitimit.

## 9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.

Disa prej masave qe duhet te zbatohen nga investitori ose nenkontratuesit per zbatimin e projektit gjate ndertimit dhe shfrytezimit te objektit.

- Subjekti kerkues, ne asnje menyre te mos kryeje punime germimi e shfrytezimi minerar, pa miratimet perketese nga MEI, MM.
- Ndertimi i impiantit, te kryhet pasi te jene marre miratimet perkatese te Njesise Administrative perkatese si leje zhvillimore, etj.
- Rrjeti inxhinierik te kryhet pasi te jene marre te gjitha miratimet perkatese nga institucionet pergjegjese te tilla si: OSHE, Albtelecom, Ujsjelles-kanalizime, MKZ, AKM, etj.
- Nese do te linde nevoja per marrjen e ujit nga burimet siperfaqesore apo hapjen e pusit, te mos kryhen punime pa u kryer me pare studimet dhe marre miratimet perkatese nga KBU, AKM, SHGJSH, etj.
- Te instalohet impiant bashkekohor, me sistem lagie te materialit dhe jo i zhurmshem.
- Per zhvillimin e aktivitetit te kryhen marreveshje me banoret dhe Bashkine ne lidhje me pronesine dhe perdorimin e tokes.

- Ne asnje menyre te mos demtohen tokat bujqesore, te perdoren tokat e pa frytshme per ndertime dhe depozitim guresh.
- Lagia e shesheve te pa shtruara gjate punimeve te ndertimit per te minimizuar ngritjen e grimcave te ngurta (pluhurave) ne ajer.
- Te sistemohet mjedisi perreth dhe te kryhen punime mbrojtese nga erozioni dhe efekti gerryeres.
- Gjate transportit te perdoren mushamate e kamionave per te shmangur perhapjen e inerteve ne rruget e qendrave te banuara dhe te rrugeve nacionale.
- Automjetet e transportit te lahen dhe pastrohen ne menyre periodike para daljes nga kantieri.
- Te mbillet bimesi e larte perreth impiantit ne menyre qe te reduktohet ndikimi ne peizazh.
- Te respektohen me perpikmeri te gjitha dispozitat ligjore si per mjedisin, per zhvillimin urban, per shfrytezimin e burimeve natyrore, etj.

## 10. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhoje edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim te mjedisit nderkufitar.

**Ing Erjona QATIPI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
«TAULANT»
Shpk
TI NË ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Mjedisore
Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit
Sektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis
Rruga "Durrësit" Nr. 27 Tiranë, Tel. 04 2256 113 Fax. 04 2270 627 - www.moe.gov.al

Nr. 50/2 Prot. Tiranë, më 04. 02 2013

Nr. identifikues 97

# ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr.1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

***Znj. ERJONA QATIPI***

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

**MINISTRI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MJEDISIT PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

**Fatmir MEDIU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

QKB
Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

Numri serial: LN-7574-03-2014
NUIS/NIPT: K51617040L

# LICENCË

Subjekti: "TAULANT" SHPK

Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE, Njësia Bashkiake nr.5, Rruga "Gjik Kuqali", pallati nr.23/2, shkalla nr.1, apartamenti nr.1, kati I-rë

Kodi: III.2.A (1+2) | Kod tjetër:

Data e lëshimit: 11/11/2015 | Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis. (auditim mjedisor dhe vlerësim i ndikimit në mjedis)

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Kufizime specifike

*Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi*

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Detyrime specifike

*Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi*

Veprimtari specifike

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

Specialiteti

Nënshkrimi i sportelit:

Ky dokument mbetet pronë e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji ose ndërpritet detyrimi ligjor për të qenë person i tatueshëm.